# ГЛАСИЛО
# GAZETË

Март 2022
Mars 2022



## ЗЕЛС

ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

## BNJVL

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



**Почитувани,**

На 30 март 2022 година, претставници од Управниот одбор на ЗЕЛС се сретнаа со членови од Владата на РСМ, предводени од премиерот Димитар Ковачевски. Оваа средба се одржа на иницијатива на Управниот одбор на ЗЕЛС, доставена уште на почетокот на годината, кога до Владата беа испратени и конкретни предлог-решенија од ЗЕЛС за поддршка на општините за надминување на негативните последици што енергетската криза континуирано ги предизвикува врз работењето на единиците на локалната власт. На состанокот беше договорено разговорите да продолжат по обезбедувањето на конкретни податоци од општините за реалната потрошувачка на електрична енергија за сите институции во надлежност на локалните власти, вклучително и за уличното осветлување, како и утврдување на висината на цената по 1 KW, што секоја општина ја постигнала во договорот за снабдување на овој енергенс.

Ова барање беше реафирмирано на последната седница на Управниот одбор на ЗЕЛС што се одржа на 9 март 2022 година. На истата седница, членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС дискутираа и ги усвоија СИСТЕМАТИЗИРАНИТЕ СТАВОВИ на ЗЕЛС, приоритетните цели за натамошно подобрување на процесот на децентрализација во земјата и унапредување на квалитетот на услугите што се во надлежност на единиците на локалната самоуправа.

Во почетокот на март, на иницијатива на овластените градежни инспектори од општините, ЗЕЛС организираше работна средба со претставници од релевантните државни институции од оваа област на која посебно внимание беше посветено на потребата за усогласување на Законот за градење со Законот за општа управна постапка, недостигот од градежни инспектори и на потребата за обезбедување на поголема планска документација за секоја општина.

Комитетот на советите при ЗЕЛС, во текот на март одржа средба во административната зграда на ЗЕЛС и отвори повеќе дилеми за функционирањето на општинските совети. Во овој период, деветнаесет градоначалници потпишаа договори со Министерството за локална самоуправа за кофинансирање на проекти со средства од Европската Унија, меѓу кои и оние за прекугранична соработка со Република Албанија. Во рамките на Програмата за прекугранична соработка меѓу Република Северна Македонија и Република Бугарија за 2021 - 2027 година, на крајот на март, во градот Сандански, беше одржана работна средба меѓу македонските и бугарските општини од пограничниот регион на која беа обновени или создадени нови партнерства за реализација на заедничките проекти.

За овие, но и за другите активности на ЗЕЛС ќе можете да прочитате поопширно на страниците од овој број на **Гласило** на ЗЕЛС.

Со почит,

**Душица Перишиќ,**
Извршен директор на ЗЕЛС

**Të nderuar,**

Më 30 mars, 2022, përfaqësuesit e Bordit drejtues të BNJVL-së u takuan me anëtarë të Qeverisë së RMV, të udhëhequr nga Kryeministri Dimitar Kovaçevski. Ky takim u realizua në iniciativë të Bordit drejtues të BNJVL-së, e cila ishte parashtruar që në fillim të vitit, kur në Qeveri u dërguan edhe propozim-zgjidhje konkrete nga BNJVL për përkrahjen e komunave lidhur me tejkalimin e pasojave negative që kriza energjetike në vazhdimësi i shkakton mbi punën e njësive të pushtetit lokal. Në mbledhje u dakordua që bisedimet të vazhdojnë mbi sigurimin e të dhënave nga komunat për konsumin real të energjisë elektrike, përfshirë edhe për ndriçimin rrugor, si dhe për përcaktimin e çmimit për 1 KW që çdo komunë e ka arritur në marrëveshjet për furnizim të energjencëve.

Kërkesa në fjalë u riafirmua në seancën e fundit të Bordit drejtues të BNJVL-së që u mbajt më 9 mars, 2022. Në seancën e njëjtë, anëtarët e Bordit drejtues të BNJVL-së diskutuan dhe i miratuan Qëndrimet e sistematizuara të BNJVL-së, prioritetet më të larta për përmirësimin e mëtejmë të procesit të decentralizimit në vend dhe avancimi i cilësisë së shërbimeve që janë në kompetencë të njësive të vetëqeverisjes lokale.

Në fillim të muajit mars, në iniciativë të inspektorëve të autorizuar ndërtimorë nga komunat, BNJVL organizoi takim punues me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore relevante nga ky takim në të cilin vëmendje e veçantë i kushtohet nevojës për harmonizim të Ligjit për ndërtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, mungesën e inspektorëve ndërtimorë dhe nevojën për sigurimin e dokumentacionit më të madh planifikues për çdo komunë.

Komiteti i këshillave në kuadër të BNJVL-së gjatë muajit mars zhvilloi takim në ndërtesën administrative në BNJVL dhe hapi shumë dilema nga funksionimi i këshillave komunale. Në këtë periudhë edhe nëntëmbëdhjetë kryetarë komunash firmosën marrëveshje me Ministrinë për vetëqeverisje lokale për ko-financim të projekteve me mjetet e Bashkimit Evropian, midis të cilave edhe ato për bashkëpunim ndërkufitar me Republikën e Shqipërisë. Në kuadër të Programit për bashkëpunim ndërkufitar midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë për vitin 2021-2027 në fund të muajit mars, në qytetin Sandanski, u mbajt takim punues midis komunave maqedonase dhe bullgare nga rajoni ndërkufitar në të cilin u përtërinë ose u krijuan partneritete të reja për realizimin e projekteve të përbashkëta.

Për këto, por edhe për aktivitete tjera të BNJVL-së do të mund të lexoni më gjërë në faqet e këtij numri të Gazetës së BNJVL-së.

Me respekt,

**Dushica Perishiq,**
Drejtori ekzekutiv i BNJVL-së


**ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**
тел. +389 (0) 2 30 99 033, факс: +389 (0) 2 30 61 994
ул. Копенхагенска бр. 5, п.фах 32,
1000 Скопје, Република Северна Македонија
**Извршен директор на ЗЕЛС:**
Душица Перишиќ
**Заменик извршен директор на ЗЕЛС:**
Ардита Дема-Мехмети
**Подготвила:**
Весна Арсовска-Динковска
**Превод:** Арта Абази
**Лекторирал:** Валентина Великова
**Дизајн и подготовка и печатење:** Европа 92

**BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**
tel. +389 (0) 2 30 99 033, faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. „Kopenhagenska“ nr. 5, F.P. 32,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
**Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Dushica Perishiq
**Zëvendes drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Ardita Dema-Mehmeti
**Përgatiti:**
Vesna Arsovska-Dinkovska
**Përkthim:** Arta Abazi
**Lektoron:** Valentina Velikova
**Dizajnim dhe përgatitje shtyp:** Evropa 92

## РАБОТНА СРЕДБА НА ОВЛАСТЕНИТЕ ГРАДЕЖНИ ИНСПЕКТОРИ СО ПРЕТСТАВНИЦИ ОД РЕЛЕВАНТНИТЕ ИНСТИТУЦИИ ОД ОВАА ОБЛАСТ

Сите овластени градежни инспектори од општините да се состанат во најбрз временски рок и да утврдат конкретни забелешки на спорните одредби од Законот за градење, со цел расчистување на правните дилеми со кои се соочуваат при неговото секојдневно имплементирање. Утврдените предлог-измени потоа ќе бидат доставени на разгледување пред телата на ЗЕЛС, а нивните ставови ќе бидат изнесени пред работната група за изработка на нов закон за градење, каде што ЗЕЛС има свој претставник.

Ова беше еден од заклучоците донесени на работната средба „Вршење на инспекциски надзор во областа на градежништвото на локално ниво" што се одржа на 2 март 2022 година во Скопје, во организација на ЗЕЛС. На средбата присуствуваа четириесетина овластени градежни инспектори од општините и претставници од: Државната комисија за одлучување од втор степен во областа на инспекцискиот надзор и прекршочна постапка, Државниот градежен инспекторат, Инспекцискиот совет и Секторот за управно надзорни работи за одлучување во втор степен од Министерство за транспорт и врски, кои имаа можност да дискутираат за многу предизвици со кои се соочуваат при имплементирањето на законските одредби од оваа област во нивното работење.

### Потребно е усогласување на Законот за градење со Законот за општа управна постапка

По обемната дискусија, присутните истакнаа дека има потреба од усогласување на Законот за градење со Законот за општа управна постапка, како системски закон, особено во областа на надзор и на извршување. Инспекторите посочија дека голем број на поднесени жалби по нивните решенија, се однесуваат токму на ситните пропусти во процедурата, што доведува до натамошно одолговлекување и нарушување на целата постапка на заштита на јавниот интерес. И претставниците од Државната комисија за одлучување од втор степен во областа на инспекцискиот надзор и прекршочна постапка укажаа дека се соочуваат со ситуации во кои е очигледна повредата на јавниот интерес утврдена во инспекциска постапка, а сепак предметот да биде вратен и поради најмала повреда на процедуралниот дел. Затоа, Комисијата посочи дека

## TAKIM PUNUES I INSPEKTORËVE TË AUTORIZUAR NDËRTIMORË ME PËRFAQËSUESIT E INSTITUCIONEVE RELEVANTE NGA KJO LËMI

Të gjithë inspektorët e autorizuar ndërtimorë nga komunat të mbajnë takim në afat më të shpejtë kohor dhe të përcaktojnë vërejtje konkrete të dispozitave kontestuese nga Ligji për ndërtim, në drejtim të qartësimit të dilemave juridike me të cilat ballafaqohen gjatë implementimit të përditshëm. Propozim-ndryshimet e përcaktuara pastaj do të parashtrohen për shqyrtim para trupave të BNJVL-së, ndërsa qëndrimet e tyre do të parashtrohen para Grupit punues për hartimin e Ligjit të ri për ndërtim, ku BNJVL ka përfaqësuesin e saj.

Kjo ishte nga konkluzionet e miratuara në takimin punues „Kryerja e mbikëqyrjes inspektive për lëminë e ndërtimtarisë në nivel lokal" që u mbajt më 02 mars, 2022, në Shkup, në organizim të BNJVL-së. Në takim morrën pjesë rreth 40 inspektorë ndërtimorë nga komunat të cilët patën mundësi të diskutojnë me përfaqësuesit e ftuar nga: Komisioni shtetëror për të vendosur në shkallë të dytë në lëminë e mbikëqyrjes inspektive dhe procedura kundërvajtëse, Inspektorati shtetëror ndërtimor, Këshilli inspektues dhe Sektori për punë administrative-mbikëqyrëse për të vendosur në shkallë të dytë në kuadër të Ministrisë për transport dhe lidhje, lidhur me shumë sfida me të cilat ballafaqohen komunat gjatë implementimit të dispozitave ligjore nga kjo lëmi në punën e saj.

### Është i nevojshëm harmonizim i Ligjit për ndërtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative

Pas diskutimit të gjerë, të pranishmit theksuan se ekziston nevoja për harmonizimin e Ligjit për ndërtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, si ligj sistemor, veçanërisht në pjesën e mbikëqyrjes dhe zbatimit. Inspektorët theksuan se një numër i madh i ankesave kundër vendimeve të tyre, i referohen pjesës së lëshimeve të vogla në procedurë, gjë që sjell zvarritje të mëtejshme dhe prishje të procedurës së tërë të mbrojtjes së interesit publik. Edhe përfaqësuesit e Komisionit shtetëror për vendimmarrje të shkallës së dytë në fushën e inspektimit dhe procedurës kundërvajtëse po ashtu theksuan se janë duke u ballafaquar me situata në të cilat është evident cenimi i interesit publik të konstatuar në procedurën e inspektimit dhe se lënda duhet të kthehet edhe për shkak të shkeljes më të vogël të pjesës procedurale. Në këtë drejtim, Komisioni theksoi se vepron më me kujdes dhe në mënyrë më



постапува повнимателно и поригорозно во однос на добиените жалби од оштетените странки и ги посоветува градежните инспектори да ја користат можноста за што почесто советување со правниците од општината. Тие посочија дека Законот за општа управна постапка е системски закон и има поголема правна сила во однос на материјалниот закон, на што овластените инспектори треба да обрнат посебно внимание. Стана збор и за роковите на доставата, за спроведувањето на надзор и за постапката за извршување. Беше нагласено дека извршувањето претставува голем проблем на сите дејствија во инспекциската постапка, при што беше посочено дека носител на налогот за извршување е градоначалникот, а додека не се обезбедат средства за извршување од страна на општината, налогот за извршување не се доставува.

### Недостаток од градежни инспектори

Претставниците од единиците на локалната самоуправа ја потенцираа потребата да се врати авторитетот на институцијата инспектор; да се зголеми бројот на инспекторите во општините; да им се намали обемот на обврските и да се обезбеди поголема флексибилност во законските услови за следење на обуки за добивање на лиценца на градежен инспектор. Претставникот од Инспекцискиот совет посочи дека постапуваат во согласност со законските прописи, а за нивна промена, општините може да поднесат иницијатива до Министерството за информатичко општество. Тој информираше дека само четириесетина општини имаат градежни овластени инспектори, односно лиценцирани се 58, од кои на територијата на Скопје има само пет-шест овластени градежни инспектори.

Овластените градежни инспектори и на оваа средба го изнесоа ставот дека сите инспектори треба да бидат во една институција, како што е Државниот инспекторат за градежништво и урбанизам. Наведоа повеќе причини меѓу кои: дека постојано се соочуваат со неразграничени надлежности меѓу нив и државните инспектори, дека не се заштитени при извршувањето на работните обврски и дека се подложени на различни локални влијанија.

Претставничката од Државниот инспекторат за градежништво и урбанизам истакна дека и оваа институција нема доволна кадровска екипираност, особено што дополнително е соочена со покривање и на териториите на општините кои немаат овластени градежни инспектори. Таа посочи на можноста овие општини да склучуваат меѓуопштинска соработка во оваа област. Средбата заврши со нагласување на потребата за почесто организирање на вакви средби на кои ќе се поттикне меѓусебната соработка, ќе се разменат позитивни искуства и ќе се донесат заеднички ставови за отпочнување на одредени законски измени.

rigoroze lidhur me ankesat e pranuara nga palët e dëmtuara dhe këshillon inspektorët e ndërtimit që të shfrytëzojnë mundësinë për konsultime më të shpeshta me juristët e komunës. Ata theksuan se Ligji për procedurën e përgjithshme administrative është ligj sistematik dhe ka fuqi juridike më të madhe në raport me ligjin material, të cilit inspektorët e autorizuar duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë.

U diskutua edhe mbi afatet e dorëzimit, lidhur me zbatimin e mbikëqyrjes dhe për procedurën për ekzekutim. U përmend se ekzekutimi në fjalë paraqet problem tejet të madh dhe ngarkesë për të gjitha veprimtaritë e procedurës inspektive, me ç'rast u përmend se bartës i urdhëresës për ekzekutim është kryetari i komunës, ndërsa përderisa nuk sigurohen mjete për të nga ana e komunës, urdhëresa nuk dërgohet.

### Mungesë e inspektorëve ndërtimorë

Përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes lokale theksuan nevojën për rikthimin e autoritetit të institucionit - inspektorit, për rritjen e numrit të inspektorëve nëpër komuna; vëllimin e obligimeve të tyre dhe të sigurojnë fleksibilitet më të madh në kushtet ligjore për ndjekjen e trajnimeve për marrjen e licencës së inspektorit të ndërtimit. Përfaqësuesi i Këshillit Inspektues theksoi se veprojnë në konform me rregulloreve ligjore dhe për ndryshimin e tyre komunat mund të paraqesin iniciativë në Ministrinë për shoqëri informatike. Ai informoi se vetëm dyzet komuna kanë inspektorë të certifikuar ndërtimor, gjegjësisht 58 janë të licencuar, nga të cilët në territorin e qytetit të Shkupit janë vetëm rreth pesë apo gjashtë inspektorë të certifikuar ndërtimor.

Edhe inspektorët e autorizuar të ndërtimit në këtë takim shprehën qëndrimin që të gjithë inspektorët të jenë në një institucion, siç është Inspektorati shtetëror për ndërtimtari dhe urbanizëm. Ata përmendën një sërë arsyesh, duke përfshirë: se përballen vazhdimisht me kompetenca të pakufizuara mes tyre dhe inspektorëve shtetërorë, se nuk mbrohen në kryerjen e detyrave të tyre dhe se janë të nënshtruar në ndikime të ndryshme lokale.

Përfaqësuesja e Inspektoratit shtetëror për ndërtimtari dhe urbanizëm përmendi se edhe ky institucion nuk ka ekipim të mjaftueshëm kadrovik, veçanërisht që në mënyrë plotësuese ballafaqohet me mbulimin e territoreve të komunave të cilat nuk kanë inspektorë të autorizuar ndërtimorë. Ajo përmendi se mundësinë që këto komuna të lidhin bashkëpunim ndërkomunal në këtë lëmi. Takimi përfundoi me theksimin e nevojës për organizim më të shpeshtë të takimeve të këtilla të cilat do të nxisin bashkëpunimin e ndërsjellë, do të shkëmbejnë praktikat pozitive dhe do të miratojnë qëndrime të përbashkëta për ngritjen e ndryshimeve të caktuara ligjore.







## ВЛАДАТА ИТНО ДА СЕ ПРОИЗНЕСЕ ЗА ДОСТАВЕНИТЕ ПРЕДЛОГ-РЕШЕНИЈА ЗА НАДМИНУВАЊЕ НА ПРЕДИЗВИЦИТЕ СО ЕНЕРГЕТСКАТА КРИЗА - СТАВ НА УПРАВНИОТ ОДБОР НА ЗЕЛС

Владата на РСМ во рок од седум дена да одговори на доставените барања и предлози од ЗЕЛС, упатени уште пред два месеца, за утврдување на заеднички решенија за надминување на предизвиците од енергетската криза со кои се соочуваат единиците на локалната самоуправа. Членовите на Управниот одбор посочија дека доколку во овој рок Владата не се произнесе, ќе се смета дека нема интерес за заедничко разрешување на предизвикот. Затоа беше договорено за седум дена, Управниот одбор да одржи нова седница на која ќе бидат дефинирани конкретните чекори за натамошно постапување на локалните власти.

Ова беше еден од заклучоците донесени на петтата седница на Управниот одбор на ЗЕЛС, што се одржа на 9 март 2022 година, во административната зграда на ЗЕЛС. На седницата беа усвоени и СИСТЕМАТИЗИРАНИТЕ СТАВОВИ на ЗЕЛС, документ во кој се опфатени сите приоритетни прашања на единиците на локалната самоуправа за натамошен развој на децентрализацијата и за подобрувањето на квалитетот на спроведувањето на префрлените надлежности. Овој документ ќе биде испратен до Владата на РСМ, заедно со реафирмираното барање за одржување на итна заедничка средба меѓу членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС, премиерот на РСМ и релевантните министри од Владата.

Присутните посочија дека непочитувањето на локалната власт, што во изминатите два месеца го покажа Владата на РСМ, игнорирајќи го барањето и предлозите упатени од ЗЕЛС за разрешувањето на предизвиците од енергетската криза, не може и не смее да се толерира и понатаму. Владата треба да им е вистински партнер на единиците на локалната самоуправа и на ЗЕЛС кога станува збор за обезбедување на услуги за граѓаните. Нагласено беше дека е потребно да се преземат соодветни чекори во насока на спречување на целосното блокирање на функционирањето на локалната власт поради

## QEVERIA URGJENTISHT TË PRONONCOHET MBI PROPOZIM-ZGJIDHJET E PARASHTRUARA LIDHUR ME TEJKALIMIN E SFIDAVE ME KRIZËN ENERGJETIKE – QËNDRIM I BORDIT DREJTUES TË BNJVL-SË

Qeveria e RMV-së t'u përgjigjet në afat prej shtatë ditësh kërkesave dhe propozimeve të dorëzuara të BNJVL-së, të dërguara dy muaj më parë, për të përcaktuar zgjidhje të përbashkëta për tejkalimin e sfidave të krizës energjetike me të cilat ballafaqohen njësitë e vetëqeverisjes lokale. Anëtarët e Bordit drejtues theksuan se nëse në këtë afat Qeveria nuk prononcohet, do të konsiderohet se nuk ka interes për tejkalim të përbashkët të sfidës. Prandaj, u dakordua që për shtatë ditë, gjegjësisht të mërkurën e ardhshme, Bordi drejtues të mbajë një seancë të re në të cilën do të përcaktohen masat konkrete për veprim të mëtutjeshëm të pushteteve lokale.

Ky ishte një nga konkluzionet e miratuara në seancën e pestë të Bordit drejtues të BNJVL-së që u mbajt më 9 mars 2022 në ndërtesën administrative të BNJVL-së. Në seancë u miratuan edhe QËNDRIMET E SISTEMATIZUARA të BNJVL-së, dokument në të cilin përfshihen të gjitha çështjet prioritare të njësive të vetëqeverisjes lokale për zhvillimin e mëtutjeshëm të decentralizimit dhe për përmirësimin e cilësisë së zbatimit të kompetencave të transferuara. Ky dokument do t'i dërgohet Qeverisë së RMV-së, së bashku me kërkesën e riafirmuar për mbajtjen e takimit të përbashkët urgjent të anëtarëve të Bordit drejtues të BNJVL-së me Kryeministrin e RMV-së dhe ministrat relevantë të Qeverisë.

Të pranishmit theksuan se mosrespektimi i pushtetit lokal të cilin e tregoi Qeveria e RMV-së në dy muajt e fundit, duke injoruar kërkesën dhe propozimet e dërguara nga ana e BNJVL-së për zgjidhjen e sfidave të krizës energjetike, nuk mund dhe nuk guxon të tolerohet më tutje. Qeveria duhet të jetë partner i vërtetë i njësive të vetëqeverisjes lokale dhe BNJVL-së kur bëhet fjalë për sigurimin e shërbimeve për qytetarët. U theksua se është e nevojshme të ndërmerren hapat e duhur për të parandaluar bllokimin e tërësishëm të funksionimit të pushtetit lokal për shkak të pamundësisë




неможноста за исплаќање на високите сметки за електрична енергија, но и високите цени на другите енергенси. Она што им претстои на општините е таложење на огромни долгови, нефукционалност, особено на помалите општини, како и нереализирање на голем број значајни проекти наменети за подобрување на квалитетот на услугите и животот на граѓаните. Доколку и по новото упатено барање за заедничка средба во рок од седум дена тоа не се случи, следната недела ќе бидат конкретизирани мерките што ќе ги преземат општините за надминување на оваа состојба.

### Усвоени систематизираните ставови на ЗЕЛС

Присутните дискутираа и за предлог-систематизираните ставови на ЗЕЛС и ги усвоија. Станува збор за утврдени приоритетни прашања кои се од значење за развојот на локалната самоуправа  во сите области што се во надлежност на локалната власт. Пред сè станува збор за обезбедување поголем обем на децентрализација на власта, односно пренесување на поголем опфат на надлежности од државните органи на управата во надлежност на единиците на локалната самоуправа, но само со обезбедување на соодветно финансиско покривање за спроведување на услугите, во согласност со Европската повелба на локалната самоуправа. Потоа, приоритет претставува обезбедувањето на поголема финансиска самостојност на ЕЛС преку обезбедување на најмалку 10 проценти од зафаќањето од ДДВ во полза за општините и 50 % од персоналниот данок; обединување и управување со капиталните инвестиции на локално ниво од страна на општините; иницирање на законски измени со цел обезбедување на поголема покриеност на територииите на општините со урбанистичка планска документација; обезбедување на повеќе средства во блок дотациите за образованието; поддршка на руралните општини преку разни облици и концесии каде локалната власт ќе има  значајна улога во донесувањето на одлуките и собирањето на поголем процент од финансиските средства; обезбедување на адекватни услови за зголемување на  приходите од данокот на имот и слично.

për të paguar faturat e larta të energjisë elektrike, por edhe çmimet e larta të energjensave të tjerë. Ajo që i pret komunat është akumulimi i borxheve të mëdha, mosfunksionimi sidomos i komunave më të vogla, si dhe mosrealizimi i një numri të madh të projekteve të rëndësishme që synojnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe jetës së qytetarëve. Nëse kjo nuk ndodh edhe krahas kërkesës së re së dërguar për një takim të përbashkët në afat prej shtatë ditësh, javën e ardhshme do të konkretizohen masat që do t'i ndërmarrin komunat për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

### U miratuan qëndrimet e sistematizuara të BNJVL-së

Të pranishmit diskutuan edhe për propozimin - QËNDRIMET E SISTEMATIZUARA të BNJVL-së dhe i miratuan të njëjtat. Bëhet fjalë për çështje të përcaktuara prioritare të rëndësishme për zhvillimin e vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat që janë nën kompetencën e pushtetit lokal. Para së gjithash, bëhet fjalë për sigurimin e një vëllimi më të madh të decentralizimit të pushtetit, gjegjësisht transferimin e një numri më të madh të kompetencave nga organet e administratës shtetërore në kompetencë të njësive të vetëqeverisjes lokale, por vetëm me sigurimin e një mbulimi adekuat financiar për zbatimin e shërbimeve, në përputhje me Kartën evropiane të vetëqeverisjes lokale. Pastaj, prioritet është sigurimi i pavarësisë më të madhe financiare të NJVL duke siguruar së paku 10 përqind të mbulimit të TVSH-së dhe 50 përqind të tatimit mbi të ardhurat personale në favor të komunave. Bashkimi dhe menaxhimi i investimeve kapitale në nivel lokal nga ana e komunave. Inicimi i ndryshimeve ligjore për të siguruar mbulim më të madh të territoreve të komunave me dokumentacion planifikues urbanistik; sigurimi i më shumë mjeteve në bllok dotacionet për arsimin; mbështetje për komunat rurale përmes formave dhe koncesioneve të ndryshme ku pushteti lokal do të ketë një rol të rëndësishëm në vendimmarrjen dhe grumbullimin e një përqindjeje më të madhe të mjeteve financiare; sigurimi i kushteve adekuate për rritjen e të hyrave nga tatimi në pronë dhe të ngjashme.





**Агенцијата за катастар на недвижности да ги префрли податоците на имателите на имот на општините**

Присутните дискутираа и за несоодветниот однос што го добиваат општините од Агенцијата за катастар на недвижности за префрлањето на податоците на имателите на имот заради негово оданочување. Тоа е особено важно за општините да можат да обезбедат повеќе финансиски приходи по овој основ. Беше посочено дека на некои општини не им се овозможува префрлање на податоците ниту со финансиски надоместок од општината, а уште помалку како што бара ЗЕЛС овие податоци да им се префрлаат бесплатно на општините. Ова прашање ја повлече и дискусијата за најновите измени на Законот за данок на имот, каде што се предвидува трократно поголем данок за објектите што не се користат повеќе од шест месеци, односно пет пати зголемен износ на данокот доколку нивното некористење не било навремено најавено во локалната власт.

Присутните го разгледаа и достигнатото барање од Синдикатот за станбено- деловните, комунални, локално-самоуправни, водостопански, хотелиерски, угостителски и радиодифузни организации на РСМ. Во него се бара да се поведе постапка за измени на Законот за административни службеници член 88 став 2 и 4 каде предлагачот, Министерството за информатичко општество и администрација, ја задржал постојната пракса вредноста на бодот што ја утврдува Советот на ЕЛС да не може да биде повисока од вредноста на бодот утврдена со Одлука на Владата. Наведено е дека со тоа се дерогира самостојното располагање на општината со нејзините приходи. Поради тоа се бара самостојност во распределбата на средствата со кои располага општината и самостојност во одлучувањето на вреднувањето на ангажманот и вложениот труд на администрацијата при реализацијата на надлежностите. Целта на ова е ефективна и ефикасна администрација од чиј исход зависи задоволството на крајниот корисник на услугата.

**Agjencia për kadastër të patundshmërive t'i transferoje komunave të dhënat për poseduesit e pronave**

Të pranishmit diskutuan edhe për sjelljen jo përkatëse që e marrin komunat nga ana e Agjencisë për Kadastër të Patundshmërive për transferimin e të dhënave tek pronarët e pronave për shkak të tatimimit të tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme me qëllim që komunat të mund të sigurojnë më shumë të ardhura financiare mbi këtë bazë. U theksua se disa komuna nuk lejohen të transferojnë të dhëna as me kompensim financiar nga ana e komunës, e aq më pak siç kërkon BNJVL që këto të dhëna t'u transferohen komunave pa pagesë. Kjo çështje ka iniciuar edhe diskutimin lidhur me ndryshimet më të reja të Ligjit për tatimin në pronë, ku parashihet tatim trefish më të lartë për objektet që nuk shfrytëzohen më shumë se gjashtë muaj, përkatësisht shumë pesëfish më të madhe të tatimit nëse mosshfrytëzimi i tyre nuk shpallej me kohë në pushtetin lokal.

Të pranishmit shqyrtuan edhe kërkesën e pranuar nga Sindikata e organizatave banesore – afariste, komunale, lokale – vetëqeverisëse, për ekonomizim të ujërave, hotelieri dhe radiodifuzion të RM-së. Në të kërkohet të iniciohet një procedurë për ndryshimin e Ligjit për nëpunësit administrativë, neni 88, paragrafi 2 dhe 4 ku propozuesi, Ministria e Shoqërisë Informative dhe Administratës ka ruajtur praktikën ekzistuese se vlera e pikës që e përcakton Këshilli i NJVL nuk mund të jetë më e lartë se vlera e pikës e përcaktuar me Vendim të Qeverisë. Është specifikuar se kjo derogon menaxhimin e pavarur të komunës me të hyrat e veta, për shkak të së cilës gjë kërkohet pavarësi në shpërndarjen e mjeteve që janë në dispozicion të komunës dhe pavarësi në vendimmarrjen për vlerësimin e angazhimit dhe përpjekjes së bërë nga ana e administratës në realizimin e kompetencave me qëllim që administrata të jetë efektive dhe efikase, prej rezultatit të së cilës varet kënaqësia e përdoruesit përfundimtar të shërbimit.

## КОМИТЕТОТ НА СОВЕТИТЕ ПРИ ЗЕЛС ДИСКУТИРАШЕ ЗА МОЖНОСТИ ЗА ПОКВАЛИТЕТНО ФУНКЦИОНИРАЊЕ НА ОПШТИНСКИТЕ СОВЕТИ

Комитетот на советите при ЗЕЛС, на 17 март 2022 година, во административната зграда на Заедницата, одржа средба на која се разговараше за воспоставување на натамошниот концепт на дејствување на ова тело со цел подобрување на функционирањето на сите општински совети и донесување на квалитетни одлуки од јавен интерес. Тие беа запознаени и со досегашниот начин на работа на Комитетот и со темите и иницијативите за кои се разговарало на претходните состаноци.

## KOMITETI I KËSHILLAVE NË KUADËR TË BNJVL-SË, DISKUTOI PËR MUNDËSI PËR FUNKSIONIM MË CILËSOR TË KËSHILLAVE KOMUNALE

Komiteti i këshillave në kuadër të BNJVL-së më 17 mars, 2022, realizoi takim në ndërtesën administrative të Bashkësisë në të cilin u diskutua për themelimin e një koncepti të mëtejmë të të vepruarit të këtij trupi në drejtim të përmirësimit të funksionimit të të gjitha këshillave komunale dhe miratimi i vendimeve cilësore me interes publik. Të njëjtët u informuan edhe me mënyrën e deritanishme të punës së Komitetit dhe me temat dhe iniciativat për të cilat është biseduar në mbledhjet e mëparshme.

Присутните посочија на потребата од обезбедување на поголема самостојност во работењето на општинските совети. Истакнаа дека не е реткост претседателот на советот, па и советниците, да се соочат со игнорантски однос од општинската администрација и од градоначалникот и да не добијат соодветна професионална поддршка за спроведување на обврските. Разновидноста на областите за кои советот треба да гради ставови и да одлучува на седниците, бараат неопходна претходна поддршка од професионални лица од областите што се во надлежност на локалната власт. Во таа насока, тие посочија на потребата за организирање на соодветни обуки од страна на ЗЕЛС, пред сè во областа на финансиското работење на локалната власт и донесување и следење на буџетот на општината.

### Поддршка од администрацијата - потреба за квалитетно работење на советот

На средбата беа изнесени дилеми околу потребата за залагање за професионализација на советничката функција, по примерот на пратениците во Собранието на РСМ, или пак, професионализација само на функцијата претседател на советот. Дилема беше отворена и за прашањето за обезбедување на соодветна администрација која ќе биде посветена исклучиво на поддршка на работата на советот на општината. Причините за ваквите размислувања советниците ги образложија со сè почестото соочување на можноста за блокирање на работењето на советот поради забележителниот „раситнет“ состав на општинските совети со претставници од различни политички партии и групи избирачи, како и различноста меѓу политичката припадност на мнозинскиот дел од советот со политичката припадност на градоначалникот, кој раководи со општинската администрација. На средбата беа изнесени и други предизвици, како што е  сегашната можност дневниот ред да се надополнува на самата седница, со што советот неподготвено се впушта во расправа или одлучување без претходна соодветна подготовка за дополнетата тема. Беше посочено дека поддршката од ЗЕЛС е важна за општинските советници и дека активностите на Комитетот треба да одат кон обезбедување на генерално подобрување на функционирањето на овој многу важен орган на секоја единица на локалната самоуправа.

Të pranishmit përmendën nevojën nga sigurimi i pavarësisë më të madhe në punën e këshillave komunale. Përmendën se jo rrallë kryetari i këshillit, por edhe këshilltarët, të ballafaqohen me sjellje injorante nga administrata komunale dhe nga kryetari i komunës dhe të mos marrin përkrahje adekuate profesionale lidhur me zbatimin e obligimeve. Lloj-llojshmëria e lëmenjve për të cilat Këshilli duhet të ndërtojë qëndrimet e veta dhe të merr vendim, në seanca kërkojnë përkrahje të domosdoshme paraprake nga personat profesionalë nga kjo lëmi që janë në kompetencë të pushtetit lokal. Në këtë drejtim përmendën nevojën për organizimin e trajnimeve adekuate nga ana e BNJVL-së, para se gjithash në punën financiare të pushtetit lokal dhe miratimin dhe ndjekjen e buxhetit të komunës.

### Përkrahja nga administrata – më se e nevojshme për punën cilësore të këshillit

Gjithashtu, u parashtruan dilemat rreth nevojës për përpjekje për profesionalizmin e funksionit këshilltar, sipas shembullit të parlamentarëve të Kuvendit të RMV, ose profesionalizmit vetëm në funksion të kryetarit të Këshillit. Dilemë u hap edhe mbi çështjen për sigurimin e administratës adekuate e cila do të përkushtohet vetëm në përkrahjen e punës së Këshillit të komunës. Arsyet për mendimet e këtilla, këshilltarët i arsyetuan me ballafaqimin gjithnjë e më të shpeshtë të mundësisë për bllokimin e punës së këshillave, për shkak të përbërjes për shkak të përbërjes së dukshme „të shpërndarë" të këshillave komunale me përfaqësuesit e partive të ndryshme politike dhe grupeve të votuesve, si dhe diferenca midis përkatësisë politike të pjesës shumicë të Këshillit me përkatësi politike të kryetarit të komunës, i cili njëkohësisht udhëheq me administratën komunale. Në takim u parashtruan edhe sfida tjera, siç është mundësia që rendi i ditës të plotësohet në vetë seancën, me ç'rast këshilli i papërgatitur lëshohet në diskutim ose vendim-marrje pa ndonjë përgatitje adekuate paraprake lidhur me temën që është shtuar. U përmend se përkrahja e BNJVL-së është mjaft e rëndësishme ndaj këshilltarëve komunalë dhe se aktivitetet e Komitetit do të shkojnë në drejtim të sigurimit të përmirësimit gjeneral të funksionimit të këtij organi tejet të rëndësishëm të çdo njësie të vetëqeverisjes lokale.








## ДЕВЕТНАЕСЕТ ГРАДОНАЧАЛНИЦИ ПОТПИШАА ДОГОВОРИ ЗА КОФИНАНСИРАЊЕ НА ПРОЕКТИ СО СРЕДСТВА ОД ЕВРОПСКАТА УНИЈА

На свечената конференција „ЕУ за општините“ што се одржа на 23 март 2022 година во хотелот „Лимакс“, деветнаесет градоначалници потпишаа договори за кофинансирање и поддршка на проекти во рамките на две програми за финансирање од Европската Унија (ЕУ). Пред присутните се обратија: претседателката на ЗЕЛС, Данела Арсовска, министерот за локална самоуправа, Горан Милевски, евроамбасадорот Дејвид Гир, амбасадорката на Швајцарија, Вероник Хулман, амбасадорот на Албанија, Фатос Река и претставничката на Комитетот на регионите на Европската Унија, Јасна Габриќ, градоначалничка на Општина Трбовље во Република Словенија.

„Големиот број на доставени апликации од општините покажува дека имаме иновативни и оригинални идеи за решавање на нашите предизвици и дека сме подготвени максимално да се ангажираме за да им понудиме подобри услуги на граѓаните. Имаме идеи, но немаме доволно финансиски средства за нивна реализација. Затоа ни е потребна поголема поддршка од Европската Унија, повеќе фондови што ќе им бидат на располагање на општините за да направиме суштинска промена во квалитетот на живеење на населението  преку реализирање на поголеми инфраструктурни проекти, канализациски мрежи, прочистителни станици, стандардизирани депонии, улици и патишта, енергетски ефикасни објекти и друго. Нашите граѓани, кои географски припаѓаат на Европа, заслужуваат да се почувствуваат како дел од ова европско семејство.“

Ова го истакна Данела Арсовска, претседателка на ЗЕЛС, во обраќањето пред присутните на конференцијата. Таа изрази благодарност за довербата на Унијата кон општините. Само со програмата „ЕУ за општините“ осум општи-

## NËNTËMBËDHJETË KRYETARË TË KOMUNAVE FIRMOSËN MARRËVESHJE PËR KO-FINANCIM TË PROJEKTEVE ME MJETET E BASHKIMIT EVROPIAN

Në konferencën solemne ,,BE për komunat” që u mbajt më 23 mars, 2022, në hotelin ,,Limaks” nëntëmbëdhjetë kryetarë të komunave firmosën marrëveshje për ko-financim nga ana e Bashkimit Evropian (BE). Para të pranishmëve u drejtuan kryetarja e BNJVL-së,  Danella Arsovska, ministri për vetëqeverisje lokale, Goran Milevski, euro ambasadori Dejvid Gir, ambasadorja e Zvicrës, Veronik Hulman, ambasadori i Shqipërisë, Fatos Reka dhe përfaqësuesja e Komitetit të Rajoneve të Bashkimit Evropian, Jasna Gabriq, kryetare e komunës së Tërbovlje në Republikën e Sllovenisë.

,,Numri i aplikacioneve të dërguara nga ana e komunave tregon se ka ide inovative dhe origjinale për zgjidhjen e sfidave tona dhe se jemi të përgatitur maksimalisht të angazhohemi që t’u ofrojmë shërbime më të mira qytetarëve. Kemi ide, por nuk kemi mjete të mjaftueshme financiare për realizimin e tyre. Prandaj n’a duhet përkrahje më e madhe nga Bashkimi Evropian, më tepër fonde që do t’u jenë në dispozicion komunave, që të bëjmë ndryshim thelbësor të cilësisë së jetës së qytetarëve tanë dhe përmes realizimit të projekteve më të mëdha infrastrukturore; rrjetet e kanalizimit; stacionet për pastrim; deponitë e standardizuara; rrugët; objektet me efikasitet energjetik etj. qytetarët tanë të cilët gjeografikisht i takojnë Evropës, meritojnë të ndjehen si pjesë e kësaj familjeve evropiane “.

Këtë e theksoi në fjalimin e saj Danella Arsovska, kryetare e BNJVL-së. Ajo shprehu falënderim për besimin që Bashkimi Evropian i’a tregon komunave dhe vetëm përmes programit






ни добија директна поддршка за реализација на проекти со вкупна вредност од околу пет милиони евра.

Па така, Општина Аеродром во следните три години од овие средства ќе го реализира проектот „Нулта цврст отпад во општината“. Општина Охрид ќе реализира активности во туризмот. Општините Велес и Струмица сè повеќе се фокусираат на продолжување на активностите во областа на урбаната мобилност. Општина Врапчиште, акцентот го стави на социјалната инклузија: „Никого не оставај зад себе“. Општина Радовиш понуди оригинална иновативност во областа на енергетската ефикасност, пред сè во обновливите извори на енергија. Општина Тетово ќе го реализира проектот „Иновативни дигитални општински услуги“ и градот Скопје ќе биде поддржан за проектот за рециклирање и реупотреба на градежниот и отпадот од уривање.

Во рамките на Програмата за прекугранична соработка меѓу Македонија и Албанија, обезбедени се грантови од ЕУ за 11 проекти. Единаесет градоначалници од Полошкиот, Пелагонискиот и од Југоисточниот плански регион потпишаа договори за кофинансирање со Министерството за локална самоуправа и Швајцарската агенција за соработка и развој, кои ги обезбедуваат средствата до 15 отсто од вкупните прифатливи трошоци на овие грантови.

„BE për komunat” siguroi përkrahje të drejtpërdrejtë për projektet e tetë komunave në vlerë prej pesë milion euro.

Prandaj komuna e Aerodromit, në tre vitet e ardhshme nga këto mjete do të realizojë projektin „Zero mbeturina të ngurta në komunë”. Komuna e Ohrit do të realizojë aktivitete në pjesën e mobilizimit urban. Komuna e Vrapçishtit, theks i vendos inkluzionit social „Askënd mos e le prapa vetes”. Komuna e Radovishit ofroi inovacion në pjesën e efikasitetit energjetik, respektivisht burime të energjisë. Komuna e Tetovës do të realizojë projekt me titull „Shërbime komunale inovative digjitale” dhe Qyteti i Shkupit, do të përkrahet për projektin për riciklim dhe ripërdorim të mbeturinave nga ndërtimi dhe nga shembja.

Në kuadër të Programit për bashkëpunim ndërkufitar midis Maqedonisë dhe Shqipërisë, janë siguruar grante nga BE për 11 projekte. Njëmbëdhjetë kryetarë nga Rajoni Planifikues i Pollogut, Pellagonisë dhe nga Rajoni Planifikues Juglindor, firmosën marrëveshje për ko-financim me Ministrinë për vetëqeverisje lokale dhe Agjencinë Zvicërane për bashkëpunim dhe zhvillim, të cilat siguruan mjete deri më 15 për qind nga shpenzimet e pranueshme të përgjithshme të këtyre granteve.

ЗЕЛС 50 години заедно со општините

BNJVL 50 vite bashkë me komunat



## ПРЕДИЗВИЦИТЕ ОД ЕНЕРГЕТСКАТА КРИЗА И ПОНАТАМУ ПРЕДМЕТ НА ПРОДОЛЖЕН ДИЈАЛОГ МЕЃУ ВЛАДАТА И ЗЕЛС

Да се направи пресек на реалната потрошувачка на електричната енергија за сите институции во надлежност на општините, вклучително и за уличното осветлување, и да се утврди висината на цената по 1 KW што секоја општина ја постигнала во договорот за снабдување на овој енергент, по што Владата ќе излезе со конкретни предлог-модели за поддршка на општините за надминување на предизвиците од енергетската криза.

Ова беше еден од заклучоците што произлегоа од состанокот што се одржа меѓу членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС со претседателот на Владата на Република Северна Македонија, Димитар Ковачевски, заменик-претседателот на Владата задолжен за економски прашања и министрите за: финансии, за економија и за локална самоуправа. Состанокот се одржа на 30 март 2022 година, во просториите на Владата на РСМ, по барање на ЗЕЛС.

Беше договорено Министерството за економија да испрати до ЗЕЛС подготвен формулар во кој општините во најбрз рок ќе ги внесат бараните податоци, а потоа, на дополнителна средба, во потесен состав, ќе се дискутира за конкретните предлози што ќе ги понуди Владата. Притоа, беше посочено дека е неприфатливо за Владата да даде директна финансиска поддршка на општините, односно дека ќе се подготват модели што ќе обезбедат дополнителна додадена вредност.

На состанокот беа разгледани предлог-барањата на ЗЕЛС за спречување на катастрофалните последици за општините поради плаќањето на високите сметки за електрична енергија. Притоа, секој градоначалник говореше за специфичните состојби во својата општина, посочувајќи дека сметките што ги плаќаат за електрична енергија се повисоки за пет, па, и повеќе пати, во однос на истиот период од минатата година. Сите беа единствени дека доколку продолжи овој тренд на енергетска криза, што е засилен со воената состојба во Украина, до крајот на годината најголем број општини ќе бидат со блокирани сметки и нема да можат да испорачуваат услуги кон граѓаните. Тие посочија дека од Владата не бараат помош, туку заедничко решавање на овој предизвик во интерес на сите граѓани. Беше нагласено дека оваа состојба е и резул-

